

(TERMAT & KUSHTET E ABONIMIT(në vijim “ASISTENCA24”) dhe kontraktuesi (në vijim “Abonuesi”), bien dakord për dispozitat e mëposhtme: Abonimi është i vlefshëm për një periudhë njëvjeçare (12 muaj) nga data e aktivizimit. Abonuesi është regjistruar në pakon Europa, e cila përfshin shërbimet e përcaktuara në këtë kontratë dhe mbulon rajonin e specifikuar në faqen e parë të kontratës në përputhje me këto Terma&Kushte. Pakoja e përzgjedhur do të aktivizohet automatikisht pas realizimit të pageses nga ana e Abonuesit. Kosova, Shqipëria, Maqedonia Veriore, Mali I Zi, Serbia

NENI 1 - MBULUESHMERIA NE RAJON) 1). Asistencë në vendngjarje për defekte të vogla, duke përfshirë: Ndezjen e makinës në rast problemi me baterinë (asistencë me kablllo); Ndihmë në rast të dëmtimit të gomës, përfshirë riparimin ose ndërrimin e saj në vend. 2). Nëse defekti nuk mund të eliminohet në vend, përfshirë edhe defekte të tjera të karakterit teknik, makina do të transportohet në lokacionin e parë të zgjedhur nga Abonuesi, në përputhje me kushtet e përcaktuara në Nenin 4 të kësaj marrëveshje. 3). Numër i pakufizuar i shërbimeve të asistencës për pikat e lartcekura gjatë periudhës së vlefshmërisë së abonimit. Abonuesi ka të drejtë t'i kërkojë këto shërbime vetëm për makinën e abonuar në këtë marrëveshje.

NENI 2 - MBULUESHMERIA NE PAKO EUROPA 1). PAKO EUROPA mbulon shtetet e Rajonit ,shtetet anëtare të Bashkimit European, si dhe shtetet jashtë BE-së, por pjesë e Zonës Shengen, si në vijim: 1.1. Kosova, Shqipëria, Maqedonia Veriore, Mali I Zi, Serbia 1.2. Austria, Belgjika, Bullgaria, Kroacia, Qipro (pjesa nën kontrollin e Republikës së Qipros), Turqia (pjesa evropiane), Republika Çeke, Danimarka, Estonia, Finlanda, Franca, Gjermania, Greqia, Hungaria, Irlanda, Italia, Letonia, Lituania, Luksemburgu, Malta, Holanda, Polonia, Portugalia, Rumania, Sllovakia, Sllovenia, Spanja, Suedia. 1.3. Shtetet jashtë BE-së por pjesë e Zonës Shengen: Islanda, Lihtenshtajni, Norvegjia, Zvicra. 2). Kushtet e shërbimit për PAKO EUROPA 2.1. Mbulueshmëria e këtij abonimi vlen për maksimumi 3 (tre) raste gjatë periudhës së vlefshmërisë së kontratës. 2.2. Në rast të dëmtimit të gomës, makina do të transportohet deri te gomisteri më i afërt. Kostoja e riparimit apo ndërrimit të gomave mbulohet nga klienti . 2.3. Në rast të ndonjë defekti tjetër teknik, makina do të transportohet deri te servisi më i afërt I autorizuar. 2.4. Nëse servisi është i mbyllur për shkak të festave ose jashtë orarit zyrtar të punës, makina do të vendoset në një

parking të sigurt, i cili mbulohet nga **Asistenca 24**, deri në rihapjen e servisit. 2.5. Për udhëtarët (maksimumi 4 persona), **Asistenca 24** mbulon qëndrimin në hotel deri në shumën totale prej 200 EURO. Kjo mbështetje aplikohet edhe në rastet e defektit me goma, nëse makina nuk mund të riparohet brenda ditës. 2.6. Vetura do të qëndrojë në servis për kontroll dhe vlerësim të riparimit maksimumi 3 ditë. 3). Mbulimi i kostove të riparimit teknik (i vlefshëm vetëm për Neni 2, paragrafi 2 , nënparagrafi 2.3): Kosto e riparimit deri në 500 EURO: Mbulohet plotësisht nga klienti . Kosto nga 501 EUR deri në 1000 EUR: **Asistenca 24** kontribon vetëm për shumën që tejkalon 500 EUR, deri në maksimumin prej 500 EUR. Kosto mbi 1000 EUR: Klienti ka të drejtë të zgjedhë të përfitojë kompensim maksimal prej 500 EUR nga **Asistenca 24**, dhe të mbulojë vetëm pjesën tjetër të koston, ose të kërkojë riatdhesimin e veturës në Kosovë, në përputhje me kushtet e kontratës. 4). Riatdhesimi I makinës: Në rast të riatdhesimit, **Asistenca 24** do të organizojë transportin e veturës brenda 14 ditëve nga data e aprovimit të kërkesës për riatdhesim. Të gjitha kostot e riatdhesimit mbulohen nga **Asistenca 24**. Vetura do të dorëzohet në një servis të zgjedhur nga Abonuesi në territorin e Kosovës, ose në adresën e deklaruar prej abonuesit. **Asistenca 24** nuk mban përgjegjësi dhe nuk mbulon asnjë kosto të riparimeve që realizohen pas riatdhesimit të makinës në Kosovë. Gjithashtu, **Asistenca 24** do të sigurojë transportin e udhëtarëve (maksimumi 4 persona) me mjete publike rrugore (autobus apo tren) deri në destinacionin përfundimtar brenda territorit të Kosovës. 5). Procedura në rast pamundësie për parapagim nga **Asistenca 24** (rast shumë i rrallë): Në raste të rralla, kur **Asistenca 24** nuk mund të kryejë parapagimin për hotelin, parkingun, shërbimet e servisit shtesë apo transportin e dërguar në vendin e defektit, pagesa do të bëhet nga klienti . Klienti është i obliguar të pajiset me faturë zyrtare nga ofruesi i shërbimit dhe ta dorëzojë atë për rimbursim tek **Asistenca 24** brenda 30 ditëve nga data e pagesës. 6). PËRJASHTIME PER PAKO EUROPE. Shërbimet nuk janë të vlefshme në rastet e mëposhtme: Defektet e shkaktuara si pasojë e aksidenteve rrugore, për të cilat duhet të aktivizohet sigurimi i detyrueshëm ose sigurimi i dëmeve materiale (kasko). Përdorimi komercial i makinës në mënyrë të ndryshme nga ajo e deklaruar në abonimin, si p.sh.: qira (rent), transport mallrash ose pasagjerësh, taksi, etj.

NENI 3 - KOHA E OFRIMIT TË SHËRBIMEVE. **Asistenca 24** do të bëjë maksimumin që ndihma të arrijë sa më shpejt, por është e detyruar që, pas marrjes së kërkesës për asistim, të sigurojë intervenimin brenda një periudhe maksimale prej 60 minutash në kushte normale atmosferike rrugore brenda territorit të Kosovës, dhe 180 minuta jashtë territorit të Kosovës.

NENI 4 - TË DREJTAT DHE DETYRIMET 1). E drejta për shërbim — Abonuesi ka të drejtë të kërkojë shërbimet e përcaktuara në Nenin 1 të kësaj marrëveshje, dhe **Asistenca 24** ka detyrimin t'i ofrojë ato në përputhje me kushtet e përcaktuara. 2). Përdorim i papërshtatshëm i makinës — **Asistenca 24** nuk është e detyruar të ofrojë shërbim nëse makina nuk është përdorur në përputhje me destinimin e tij, apo nëse defekti është shkaktuar qëllimisht nga drejtuesi i mjetit. Këtu përfshihen, pa u kufizuar vetëm në këto raste: pjesëmarrje në gara, lëvizje në terrene malore ose të papërshtatshme (off-road), futje e qëllimshme në baltë apo dëborë, si dhe mospërshtatje e gomave me kushtet atmosferike sipas legjislacionit në fuqi. 3). Defektet e përsëritura — **Asistenca 24** nuk është e obliguar të ofrojë asistencë për të njëjtin defekt më shumë se një herë gjatë vitit të abonimit, nëse është dhënë më parë rekomandim për eliminimin e tij (p.sh. ndërrimi i baterisë, gomave të dëmtuara ose të vjetra, apo mbetja pa karburant).

). TEL : 049-701-000 WEB : www.asistenca24.com E-mail: info@asistenca24.com